

UDHËZIM
Nr. 12, datë 13.5.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HAPJES DHE TË MBYLLJES SË
ADRESAVE SEKONDARE TË BASTEVE SPORTIVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shoqëritë e lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive, për hapjen e adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit duhet të paraqesin në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për hapjen e pikave dhe adresën e saktë të saj;
- b) Kopje të letërnjoftimit dhe kontratës së punës për punonjësën, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë;
- c) Miratimin paraprak të marrë në AMLF nga pronari i ambientit në të cilin do të ushtrohet aktiviteti i lojërave të fatit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) Kopje e njëzuar me origjinalin e kontratës së qirasë/huapërdorjes, hartuar e nënshkruar përpara noterit, bashkëlidhur certifikata /vërtetimi i pronësisë apo dokument tjetër që provon të drejtën e qiradhënësit/huadhënësit për të poseduar dhe gëzuar ligjërisht ambientin e dhënë me qira apo në huapërdorje;

d) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Për punonjësën, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë shoqëria duhet të zotërojë në dosjen e personelit, në selinë e shoqërisë, dokumentacionin e poshtëshënuar:

- b.1 kopje e letërnjoftimit;
- b.2 vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- b.3 dëshmi kualifikimi;
- b.4 kontratë pune.

2. Shoqëritë e lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive për mbylljen e adresave sekondare duhet të paraqesin në AMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Njoftimin për mbylljen e sallës.
- b) Dokument që vërteton zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

3. Shoqëritë e lojërave të fatit nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë në një pikë të caktuar pa marrë miratimin me shkrim nga AMLF-ja për hapjen e pikës sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

4. Në udhëzimin nr. 5, datë 19.1.2009, “Për procedurat e hapjes dhe të mbylljes së sallave të lojërave basteve sportive, kazinove elektronike, bingove tradicionale” shfuqizohen vetëm dispozitat që normojnë bastet sportive.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj